



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 404/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Sinani Trading” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-14693-03-21-2019, me objekt Loti I “Blerje mish viçi ,nënproduktet e tij, mish pule dhe vezë”, Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës 11'973'800 (njëmbëdhjete milion e nteqint e shtatedhjete e tre mije e teteqint) lekë, zhvilluar në datën 23.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues:

“Argent Daci” P.F
Rruga “Abdi Bej Toptani”, Godina nr.21 Kamëz Tiranë

Autoriteti kontraktor:

Bashkia Durrës
Sheshi “LIRIA” Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.03.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-14693-03-21-2019, me objekt Loti I “*Blerje mish viçi ,nënproduktet e tij, mish pule dhe vezë*”, Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës 11'973'800 (njëmbëdhjete milion e nteqint e shtatedhjete e tre mije e teteqint) lekë, zhvilluar në datën 23.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 23.04.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 07.05.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Sinani Trading	9,142,000	I kualifikuar
- Dogel	9,192,000	I skualifikuar
- Dajti Park 2007	9,755,200	I skualifikuar
- Argent Daci	10,294,550	I kualifikuar
- Kazazi Meat	10,432,500	I skualifikuar
- Kadra	11,836,500	I skualifikuar
- Nelsa	11,454,000	I skualifikuar

II.4. Në datën 13.05.2019 operatori ekonomik ankimues “Argent Daci” P.F ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Duke qenë se fondi limit i lotit në fjalë është 11,973,800 duket që oferta e operatorit Sinai Trading shpk 9,142,000 lekë është jashtë logjikës ekonomike dhe lind dyshimi i arsyeshëm se di do mund të realizojë ky operator këtë kontratë kur me një llogari të thjeshtë vlera e tij nuk mbulon as koston. Nëse shikojmë me kujdes parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuar për produktet e këtij loti kërkohen produkte të cilësisë së parë. Kjo do të thotë që cmimi i tyre është më i larti në treg në raport me cilësitë e tjera. Bazuar në cmimet e referencës për këto produkte është e pamundur që me atë cmim të ofrohet produktet e kërkuara sipas specifikimeve teknike të publikuara nga AK . Atëherë si mundet që oferta e Sinani Trading të përmbushë detyrimin e tij me produkte të cilësisë së parë duke dalë kështu me bilanc negativ. Është shumë e qartë që qëllimi i këtij operatori është të sigurojë për ju produkte të cilësisë më të ulët si mish dhe vezë të importuara jashtë standartit të kërkuar nga ju. Neni 56 i LPP Oferta anomalisht e ulët. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:*
 - *a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
 - *b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
 - *c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
 - *ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në*
- *vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

- 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Sipas këtij neni ju duhet të merrni masat e nevojshme për të vlerësuar këtë ofertë jashtë parametrave ekonomikë për të mos rrezikuar cilësinë dhe rrjedhimisht jetën e konsumatorëve specifike.

- Gjithashtu kemi konstatuar që operatori Sinani Trading shpk është skualifikuar në tendera të tjerë të këtij viti për mosplotësimin e kontratave të ngjashme dhe për parregullsi në dokumentacion, gje që na con të mendojmë që dokumentat konkurruese të paraqitura kanë qenë të rreme. Për të vërtetuar këtë ju kemi nisur shkresë sipas ligjit që të na vini në dispozicion dokumentat e kërkuara por nuk na keni kthyer përgjigje. Sipas nenit 45/2 e LPP kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë: Cdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë në rastet kur: e) është fajtor për dhënie të informacionit të rremë kur këto i janë kërkuar në përpunje me këtë kre ose nuk ka pranuar ti japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre. Dmth ju keni kualifikuar një subjekt që nuk përmbush minimalisht një nga kushtet kryesore të kërkuara që është oferta brenda parametrave logjik ekonomik duke përfshirë cmimin tavan dhe cmimin dysheme. Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Sinani Trading shpk dhe shpalljen e ofertës sonë fituese.

II.5. Me shkresën nr.3707/2 prot datë 15.05.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje OE ankimues duke vendosur refuzimin e ankesës dhe sqaruar ankimuesin se oferta e Sinani Trading nuk është anomalisht e ulët.

II.6. Në datën 24.05.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.10290/1 prot datë 06.06.2019 protokolluar me tonën me nr.938/2 prot datë 07.06.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” P.F “Duke qenë se fondi limit i lotit në fjalë është 11,973,800 duket që oferta e operatorit Sinani Trading shpk 9,142,000 lekë është jashtë logjikës ekonomike dhe lind dyshimi i arsyeshëm se di do mund të realizojë ky operator këtë kontratë kur me një llogari të thjeshtë vlera e tij nuk mbulon as koston. Nëse shikojmë me kujdes parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuar për produktet e këtij loti kërkohen proukte të cilësisë së parë. Kjo do të thotë që cmimi i tyre është më i larti në treg në raport me cilësitë e tjera. Bazuar në cmimet e referncës për këto produkte është e pamundur që me atë cmim të ofrohet produktet e kërkuara sipas specifiikimeve teknike të publikuara nga AK . Atëherë si mundet që oferta e Sinani Trading të përmbushë detyrimin e tij me produkte të cilësisë së parë duke dalë kështu me bilanc negativ. Është shumë e qartë që qëllimi i këtij operatori është të sigurojë për ju produkte të cilësisë më të ulët si mish dhe vezë të importuara jashtë standartit të kërkuar nga ju. Neni 56 i LPP Oferta anomalisht e ulët. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës”. Sipas këtij neni ju duhet të merrni masat e nevojshme për të vlerësuar këtë ofertë jashtë parametrave ekonomike për të mos rezikuar cilësinë dhe rrjedhimisht jetën e konsumatorëve specifike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohes se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.1.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomik – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetin kontraktor do t’i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, autoriteti kontraktor, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të dorëzuar nga operatori ekonomik “Sinani Trading” shpk ashtu sikundër ka sqaruar edhe autoriteti kontraktor në kthim përgjigjen drejtuar ankimuesit, oferta nuk rezulton anomalisht e ulët. Në këto kushte autoriteti kontraktor nuk ka detyrimin në bazë të LPP të vlerësojë përgjegjshmërinë e ofertës ekonomike të operatorit ekonomik sa kohë që ajo nuk është në kufirin që parashkon ligji të një oferte anomalisht të ulët.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Argent Daci” shpk “Gjithashtu kemi konstatuar që operatori Sinani Trading shpk është skualifikuar në tendera të tjerë të këtij viti për mosplotësimin e kontratave të ngjashme dhe për parregullsi në dokumentacion, gje që na con të mendojmë që dokumentat konkurruese të paraqitura kanë qenë të rreme. Për të vërtetuar këtë ju kemi nisur shkresë sipas ligjit që të na vini në dispozicion dokumentat e kërkuara por nuk na keni kthyer përgjigje. Sipas nenit 45/2 e LPP kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë: Cdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë në rastet kur: e) është fajtor për dhënie të informacionit të rremë kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre ose nuk ka pranuar ti japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- a. Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo me te ulet se 40 % lekë, per operoret ekonomik qe do te ofertojne per nje ose disa lote, duhet të kenë një vlerë jo më të ulët se 40 % lekë e fondit limit te lotit perkates, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Sinani Trading” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakt Historik i subjektit “Sinani Trading” shpk nga ku rezulton se më datë 27.03.2018 është bërë ndryshimi i emrit të subjektit dhe emrit tregëtar nga MB Kurti shpk në Sinani Trading shpk.
- Kontratë Nr.1529 Prot datë 27.01.2017 me objekt “Blerje ushqimesh” lidhur ndërmjet Bashkia Durrës dhe “MB Kurti” shpk me vlerë të kontratës 22,615,400 lekë pa tvsh, Vërtetim Realizimi Nr.77 prot datë 15.11.2017 lëshuar nga Qendra Ekonomike e Arsimit Durrës, Vërtetim Realizimi nr.ext prot datë 15.11.2017 lëshuar nga Qendra Ditore e të Moshuarve.
- Kontratë Furnizimi Nr.101 prot datë 01.06.2017 me objekt “Blerje Mish dhe nënproduktet e tij” me vlerë totale 2,724,500 lekë pa tvsh lidhur ndërmjet MB Kurti dhe Shtëpia e Pushimit e MPB Durrës. Vërtetim Për Realizim Kontrate nr.41 prot datë 07.02.2018 lëshuar nga Shtëpia e Pushimit Durrës.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese aftësia teknike: b) operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.2.4. Në nenin 27 “Kontartat e Mallrave”, pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkondëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "Sinai Trading" sh.p.k., vërteton se plotëson kërkesat për kualifikim, për përvojë të suksesshme të ngjashme, pasi kontratat e paraqitura, janë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit. Akoma më tej vlera e kontratave të paraqitura nga shoqëria "Sinani Trading" sh.p.k jo vetëm përmbushin vlerën e kërkuar prej 40% të fondit limit të prokuruar nga ana e autoritetit kontraktor por e tejkalojnë disa herë atë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik "Sinani Trading" shpk konkretisht "për parregullsi në dokumentacion, gje që na con të mendojmë që dokumentat konkurruese të paraqitura kanë qenë të rreme. Sipas nenit 45/2 e LPP kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë: Cdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë në rastet kur: e) është fajtor për dhënie të informacionit të rremë kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre ose nuk ka pranuar ti japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre", KPP gjykon se kto janë pretendime të ngritura apriori në mënyrë të përgjithshme dhe nuk merren në shyrtime nga KPP. Për më tepër që pretendime të kësaj natyre mund ti drejtohen organeve të tjera kompetente të ngarkuara me ligj.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Argent Daci” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-14693-03-21-2019, me objekt Loti I “*Blerje mish viçi ,nënproduktet e tij, mish pule dhe vezë*”, Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës 11'973'800 (njëmbëdhjete milion e nteqint e shtatedhjete e tre mijë e teteqint) lekë, zhvilluar në datën 23.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 938 Protokolli; Datë 24.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha